

V E N D I M
Nr.80, datë 21.2.1994

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.516, DATË
1.11.1993 “PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE
NR.306, DATË 21.6.1993 “PËR ORGANIZIMIN E SISTEMIT TË FORMIMIT
PROFESIONAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË””**

Me propozimin e Ministrisë së Punës, të Emigracionit dhe të Përkrahjes Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.516, datë 1.11.1993, pika 6 ndryshohet si vijon:

“Kursantët që janë të regjistruar si të papunë në zyrat përkatëse të punës dhe që kanë dalë nga skema e pagesës së papunësisë ose e ndihmës ekonomike, të cilët ndjekin kurset e kualifikimit të organizuara nga Ministria e Punës, Emigracionit dhe e Përkrahjes Sociale, përfitojnë një pagesë fikse mujore nga buxheti i zyrave të punës për formim profesional, në masën 70 për qind të vlerës së pagesës së papunësisë.

Pagesa do të bëhet nga zyrat e punës ku ata janë të regjistruar përkundrejt vërtetimeve të lëshuara nga qendra e formimit profesional lidhur me frekuentimin e rregullt të kursit”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi